



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 38/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) - KQZ, për tërheqjen e ankesës së parashtuar ndaj Yll Isufit, nga komuna e Gjilanit, kandidat i pavarur për Zgjedhjet Lokale 2013 në seancën e panelit të mbajtur me 12.03.2014, mori këtë:

V E N D I M

Konstatohet e tërhequr ankesa që ka të bëjë me Yll Isufi, kandidat i pavarur për Zgjedhjet Lokale 2013, të parashtuara në PZAP nga Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) - KQZ.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar nga ZRPPC-ja një kërkesë për tërheqjen e ankesës të parashtuara në PZAP kundër Yll Isufit, kandidat i pavarur për Zgjedhjet Lokale 2013, në të cilën kërkohet që të tërhiqet nga shqyrtimi ankesa e lartpërmendur pasi që kandidati në fjalë e ka dorëzuar raportin financiar të shpenzimit të fushatës zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqje e ankesës së sipërshtuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohet pjesa që ka të bëjë me kandidatin në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 38/2014 më datën 12.03.2014

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

